

**UDHEZIM**  
**PER**  
**KERKESAT DHE MENYREN E ZONIMIT TE TERRITORIT**  
**TE NJE ZONE TE MBROJTUR**

**1. HYRJE**

Zonat e mbrojtura (**ZM**) ne pergjithesi duhet te mbrojne, ruajne, permiresojne, zhvillojne, krijojne, modelojne dhe mirembajne ?? natyren, ekosistemet, habitatet, peizazhet, llojet e flores e faunes se eger, perdorimin e mencur te vlerave tradicionale, historike dhe kulturore dhe ne rruge ligjore apo me masa te tjera efektive.

Nje zone e mbrojtur pa asnje rregull apo kufizim, mbi aktivitetet njerezore, nuk mund te quhet “zone e mbrojtur”. Pa keto rregulla dhe kufizime te qarta, te kuptueshme, te pranuar dhe te zbatueshme zona e mbrojtur nuk mund te menaxhohet si duhet pervec rasteve kur eshte e vete-mbrojtur per shkak te largesise, pa mberritshmerise apo si rrjedhoje e pengesave te tjera natyrore apo kulturore qe perjashtojne teresisht ndikimet njerezore.

Formulimi i rregulloreve dhe i kufizimeve te pershtatshme per zonat e mbrojtura eshte nje detyrim i qeverise (ligji) dhe zbatimi i tyre eshte pergjegjesi e administrates (ekzekutimi). Menaxhimi i zonave te mbrojtura kerkon hartimin e udhezimeve te qarta, shpesh ne formen e planeve te menaxhimit, te percaktuara dhe diskutuara me gjithe aktoret e tjere.

Shume zona te mbrojtura, vecanerisht ato te medhate, kane nje strukture shume komplekse, duke u shtrire ne zona vertet natyrore dhe ne ato qe jane apo kane qene nen ndikimin njerezor. Per ti bere sa me te qarta dhe me te sakta rregulloret dhe kufizimet per zonat e mbrojtura, ne shume prej tyre eshte krijuar sistemi i zonimit, per te rregulluar menaxhimin me intensitetin e ndryshem te aktiviteve njerezore. Per shembull, parqet kombetare ne Shqiperi perfaqesojne peizazhe teper komplekse, ku perfishihen zona verteta natyrore, pyje te shfrytezuara e te pa shfrytezuara, terrene bujqesore, kopshte, livadhe, kullota, por edhe rruge, vendbanime si dhe njesi tregtare.

Eshte e kuptueshme qe konsiderimi i gjithe ketyre aspekteve ne nje plan menaxhimi standard do te nxjerre shume probleme. Zgjidhja eshte ndarja e territorit te zones se mbrojtur ne nenzona te ndryshme, sipas nevojave dhe shkalleve te ruajtjes se natyres, biodiversitetit, peizazhit, turizmit dhe aktiviteve te tjera njerezore, perfshire bujqesine, pyjet dhe bizneset e tjera. Kjo ndarje quhet “zonim”.

Sistemi i zonimit ndihmon ne specifikimin e menaxhimit te zonave te mbrojtura sipas nevojave dhe mundesive. Gjithashtu, lejon perfshirjen e terrioreve shtese me nje nivel te ulet (tjeter) ruajtjeje, apo ndarjen ndermjet zonave vertet natyrore dhe zonave qe ruajne habitate jo primare, por sekondare te formuara nga perdorimi tradicional ne shekuj.

Ne kuadrin e miremenaxhimit, te ruajtjes se natyres e te biodiversitet apo te llojeve faunistike te kercenuara dhe te perdorimit te mencur te burimeve natyrore te nje ZM, nenzonimi eshte nje perpjekje per te nderlidhur e integruar ruajtjen me zhvillimin, te zgjidhe konfliktet dhe te promovoje qendrueshmerine. Nenzonimi synon te promovoje perfitime te gjera shoqerore, por kjo mund te

nxise pretendime per humbjen e te drejtes per te pasur aksesese te ndryshme, ndersa disa te tjere marrin (ose rimarrin) te drejten e aksesit.

Menaxhimi i zonave te mbrojtura ne menyre efektive do te thote te sjelle keto grupe per te negociuar me rregulla transparente dhe demokratike per perdorimin e menaxhuar dhe shmangien e konflikteve.

Zonat buferike ose te perdorimit te shumefishte mund te krijohet edhe brenda zones se mbrojtur per te zbutur linjen midis ruajtjes se biodiversitetit dhe te shfrytezimit (marrjes) se burimeve.

Zonimi eshte nje nga problemet kryesore per shumicen e zonave te mbrojtura, por kjo eshte shume e rendesishme per te zgjedhur nje numer te perdorimeve te ndryshme te nje zone te mbrojtur, duke pajtuar interesa te ndryshme. Nje plan zonimi percakton kornizen per menaxhimin e zonave te mbrojtura. Pra, ai duhet te konsiderohet si dokumenti kryesor nga i cili rrjedh dhe pasohet nga plani i menaxhimit. Edhe pse nuk ka shume pervoje ne hartimin e planeve te menaxhimit, shume pak vemendje i eshte dhene zonimit, edhe pse ai eshte ne zemer te menaxhimit te nje zone te madhe te mbrojtur. Dëshmi nga disa zona te mbrojtura tregojne se zbatimi dhe aktivitetet, rralle perputhen me planin kompleks te zonimit, duke mbetur ne raftet e zyrave.

Ky udhezues shpresojme qe do te ndihmoje ne vendosjen e procedurave te qarta mbi menyren se si do te percaktohen nenzonat e ndryshme ne zonat e mbrojtura, si do te negociohet pse dhe ku duhen caktuar ato brenda nje zone te mbrojtur, si te formulohen rregulloret specifike, kufizimet dhe aktivitetet per secilen nenzone ne çdo zone te mbrojtur, dhe si te pergatiten hartat perkatese, per te pasur nje standard per gjithë zonat e mbrojtura dhe parandaluar konfuzionin ne perkufizime dhe terminologji.

## **2. QELLIMI**

Gjate procesit te implementimit te projekteve dhe hartimit te planeve te menaxhimit per zonat e mbrojtura, krahas miratimit te sturkes unike per hartimin e planit te menaxhimit, ka rezultuar si domosdoshmeri miratimi i nje udhezuesi unik e te standartizuar, per kriteret dhe menyren e zonimit te territorit te ZM, ku te perfshihen pervojat dhe standartet me te mira te perputhura me terminologji dhe formatet unike qe perdoren midis vendeve te BE-se apo dhe ne bote.

Qellimi i ketij udhezuesi eshte te vendose nje standard te pranuar per nen-zonimin e territorit te zonave te mbrojtura ne Shqiperi. Njeherazi do te tregojë rrugen konkrete per procesin e nenzonimit te territorit te zones se mbrojtur, duke marre ne konsiderate vendndodhjen, karakteristikat tipike te rajoneve biogeografike, statusin e zones se mbrojtjes, duke perdorur nje gjuhe te thjeshte e te kuptueshme per te gjithë palet e interesuara.

Perdoruesit e udhezuesit do te jene:

- a. Ministrite dhe Institucionet Shteterore.
- b. Institucioni i Prefektures, Keshilli i Qarkut.
- c. Komunat e Bashkite.
- d. Institucionet e Planifikimit te Territorrit
- e. Agjencia Kombetaree Mjedisit
- f. Institucionet Studimore-Shkencore.
- g. Institucionet private qe merren me problemet mjedisore.
- h. Shoqatat joqeveritare mjedisore.

- i. Aktore dhe grupe te tjera interesi

### 3. LEGJISLACIONI I RUAJTJES SE NATYRES

Zonat e mbrojtura jane instrumenti kryesor ne aktivitetet nderkombetare per ruajtjen e natyres. Besohet se vendet apo rajonet, me pjesen me te madhe te siperfaqes nen zonat e mbrojtura, po bejne me shume per ruajtjen e natyres e te biodiversitetit. Por, teorikisht, zonat e mbrojtura jane gjithashtu edhe nje tregues per nevojën e masave mbrojtese, dhe ne kete kuptim, nje mase e shkalles se degradimit te natyres.

Ne mbare boten, zonat e mbrojtura gjenden ne rajonet me te largeta, ne vendet me dendesi te vogel popullesie dhe presion te ulet ndaj natyres. Kesisoj kane dhe rrjete me te mira te zonave te mbrojtura qe mbulojne siperfaqe te medha. Nuk eshte as rezultat i planifikimit shkencor as aksidentale qe shumica e zonave te mbrojtura ndodhen ne zona te largeta apo zene terriore qe jane te veshtira per tu eksploruar.

Ruajtja e natyres eshte gjithnje ne telashe me presionin e perdorimit te burimeve natyrore, perfshire nevojën per siperfaqe per ndertim. Ajo çka duam te mbrojme, apo me mire, ajo çka duam te konservojme shpesh nuk eshte natyra e paprekur, por çka krijohet nga nje perdorim tradicional afatgjate apo natyra nen shfrytezim te qendrueshem apo natyra e demtuar nen rigjenerim.

Keshtu, rezervatet natyrore mund te perfaqesojne nivele te ndryshme natyraliteti, qe kerkojne apo lejojne masa te ndryshme menaxhimi apo perdorimi, perfshire ekoturizmin. Ne zonat e mbrojtura te medha ne shumicen e rasteve kemi nje mozaik te niveleve te ndryshme te natyralitetit, shpesh i nderthurur me nevoja e te drejta perdorimi nga banoret lokale. Kjo eshte arsyeja per te cilen eshte krijuar koncepti i zonimit dhe pse zonimi eshte nje instrument i pashmangshem ne menaxhimin e zonave te mbrojtura me siperfaqe te madhe.

Baza ligjore per mbrojtjen e natyres buron nga Kushtetuta, ne nenin 59 te se ciles percaktohet se shteti synon nje mjedis te shendetshem dhe ekologjikisht te pershtatshem per brezat e sotem dhe te ardhshem dhe shfrytezimin racional te burimeve natyrore mbi bazen e parimit te zhvillimit te qendrueshem.

Mbrojtja e Natyres eshte nje prej nenfushave prioritare qe lidhen me *acquis communautaire* ne fushen e mjedisit. Siç percaktohet nga MSA (neni 70/3 si dhe neni 108), perafrimi i legjislacionit shqiptar me *acquis* ne fushen e mjedisit, lidhet direkt me standardet mjedisore dhe detyren jetesore per te luftuar degradimin e mjedisit me qellim promovimin e qendrueshmerise mjedisore.

Legjislacioni shqiptar per mbrojtjen e natyres, sidomos me nenshkrimin e MSA-se dhe ne zbatim te PKZMSA-se, eshte perafruar ne nje shkalle te konsiderueshme me direktivat kryesore te BE-se per mbrojtjen e natyres: Direktiva e Shpendeve (versioni i kodifikuar 2009/147/EC) dhe Direktiva e Habitave (92/43/EC) jane transpozuar perkatesisht ne masen 85-75 % te dispozitave te tyre. Ne vecanti ligji "Per mbrojtjen e biodiversitetit" dhe ligji "Per mbrojtjen e faunes se eger", perfshijne dispozitat per mbrojtjen e llojeve e transpozuar nga dy direktivat baze te mbrojtjes se natyres. Keto se bashku me ligjin "Per zonat e mbrojtura", i ndryshuar permbajne dispozita nga dy direktive baze, lidhur me mbrojtjen e habitave brenda dhe jashte zonave te mbrojtura. Pra ky legjislacion mbeshtet dhe miremenaxhimin e zonave te mbrojtura.

Amendimi i ligjit te zonave te mbrojtura perafroj standartet me BE ne drejtim te kategorive te zonave te mbrojtjes, te shkalles se mbrojtjes se tyre per secilen nenzone, duke percaktuar me mire nivelet e mbrojtjes dhe te veprimtarive te ndaluara, te lejuara me leje mjedisore dhe sipas studimeve te vleresimit mjedisor strategjik, te studimit e planifikimit te territorit ne perputhje me vendimeve te KKT (Keshilli Kombetar i Territorit), per zonat e vecanta te ruajtjes se habitateve dhe te llojeve, per zonat Ramsar, zonat natyrore qe mund te perfshihen ne listen e UNESCO-s ose te kombinuara me ato kulturore e historike, si dhe per zonat e mbrojtura detare.

Ligji i zonave te mbrojtura Nr. 8906, date 06.06.2002, te ndryshuar, ka per objekt shpalljen, ruajtjen, administrimin, menaxhimin dhe perdorimin e qendrueshem te zonave te mbrojtura dhe te burimeve natyrore e biologjike te tyre; lehtesimin e kushteve per zhvillimin e turizmit mjedisor; per informimin dhe edukimin e publikut dhe per perfitime ekonomike, te drejtperdrejta dhe te terthorta, nga popullsia vendore, nga sektori publik dhe privat.

Nepermjet ketij ligji duhet te sigurohet nje mbrojtje te vecante te perberesve te rendesishem te rezervave natyrore, te biodiversitetit dhe te natyres, ne teresi, nepermjet krijimit te zonave te mbrojtura, ruajtjen dhe ripertertjen e habitateve natyrore, te llojeve, te rezervave dhe te peizazheve natyrore. Gjithashtu ligji rregullon mbrojtjen e 6 kategorive te zonave te mbrojtura, qe zbatohen ne territorin e Republikes se Shqiperise.

Pjese te rendesishme ose te kercenuara te territorit shpallen zona te mbrojtura, dhe kategorizimi i zonave, statusi apo dhe niveli i mbrojtjes, per secilen zone, mbeshtetet ne kriteret e Qendres Boterore te Ruajtjes se Natyres (IUCN) si me poshte:

**a. Rezerve strikte natyrore/rezervat shkencor (Kategoria I)**

Pecaktohen si teritore jo me te vogla se 50 ha, me vlera natyrore te vecanta, te formuara nga ekosisteme natyrore ose lehtesisht te ndryshueshme, qe perfaqesojne bioqendra dhe biokorridore me rendesi kombetare dhe rajonale, shpallen rezerve strikte natyrore. Ne Shqiperi ka dhe zona te tilla me siperfaqe me te medha.

**b. Park kombetar (Kategoria II)**

Territoret e gjera, zakonisht jo me te vogla se 1000 ha, unike per nga vlerat kombetare dhe nderkombetare, nje pjese e madhe e te cilave jane ekosisteme natyrore, te ndikuara pak nga veprimtaria e njeriut, ku bimet, kafshet dhe mjedisi natyror, fizik jane te nje rendesie te vecante shkencore dhe edukative, shpallen park kombetar.

**c. Monument natyror (Kategoria III)**

Formacioni natyror (perfshire edhe dru te vecante), me siperfaqe deri 50 ha, formacioni i vecante gjeologjik dhe gjeomorfologjik, nje depozite mineralesh ose nje habitat i nje lloji te rralle e te kercenuar ose me rendesi e vlere te vecante shkencore dhe estetike, shpallet monument natyror. Ne Shqiperi ka dhe zona te tilla me siperfaqe me te medha.

**ç) Rezervat natyror i menaxhuar/Park Natyror (Kategoria IV)**

Territoret qe perfaqesojne bioqendra dhe biokorridore me rendesi rajonalee vendore ose zonat me bime, kafshe, minerale e gjetje paleontologjike, vecanerisht te mbrojtura ose zonat qe perdoren per qellime studimore, edukative dhe kulturore shpallen rezervat natyror i menaxhuar (zone e menaxhimit te habitateve dhe llojeve).

**d. Peizazh i mbrojtur (Kategoria V)**

Territoret me te medha se 1000 ha, me peizazh harmonik e te formuar mire, me relief te zhvilluar karakteristik, me larmi ekosistemesh, detare ose tokesore, me monumente historike, shpallen peizazh i mbrojtur.

**dh) Zone e mbrojtur e burimeve te menaxhuara/zone e mbrojtur me perdorim te shumefishte (Kategoria VI)**

Zonat qe perfshijne territore te gjera e relativisht te izoluara dhe te pabanuara, ku hyhet me veshtiresi ose rajone qe jane ende pak te populluara dhe qe mund te jene nen presion te vazhdueshem per t'u populluar dhe perdorur me gjeresisht dhe kthimi i tyre per perdorim intensiv eshte i paqarte ose i papershtatshem, shpallen zona te mbrojtura te burimeve te menaxhuara.

Sipas dispozitave te ligjit "Per zonat e mbrojtura" per shpalljen zone e mbrojtur, territori duhet te plotesoje, te pakten, njeran prej kriterave te meposhtme:

- a) te kete diversitet te larte te llojeve dhe/ose te habitateve;
- b) te kete dendesi te ulet te llojeve dhe/ose habitateve;
- c) te kete perfaqesueshmeri;
- ç) te kete minimumin kritik te madhesise seekosistemit;
- d) te kete natyralitet, trashegimi dhe integritet;
- dh) te kete vlere shkencore;
- e) te karakterizohet nga prekshtmeria ekologjike/llojet e prekshtme;
- e) te karakterizohet nga paperseritshmeria/llojet endemike;
- f) te mos rrezikohet nga nderhyrjet e veprimtarive njerezore;
- g) te kete mundesi per ruajtjen e jetes seeger.

Shpallja e nje zone te mbrojtur dhe zonimi i saj behen me vendim te Keshillit te Ministrave, me propozimin e ministrit pergjegjes per mjedisin, pas marrjes se mendimit te institucioneve te specializuara dhe te organeve te qeverisjes vendore, te cilat kane marre, paraprakisht, mendimin e pronareve private, pronat e te cileve do te perfshihen ne zonen e mbrojtur. Keshilli i Ministrave miraton procedurat per propozimin dhe shpalljen e zonave te mbrojtura dhe buferike. Ato pergatiten nga Ministria e Mjedisit ne mbeshtetje te kriterave te Konventes se Biodiversitetit, te udhezimeve perkatese te Bashkimit Evropian dhe te planeve e strategjive mjedisore kombetare. Sipas ketij legjislacioni cdo person fizik a juridik ka te drejte t'i kerkoje ministrise qe territori i vet privat ose pjese e objekteve natyrore te veta, te shpallen ose te perfshihen ne njeran nga kategoritee zonave te mbrojtura.

Ne Shqiperi nuk ka standarde apo rekomandime te mirefillta lidhur me zonimin e territorit ne zonat e mbrojtura. Por zonimi si nje instrument shume i perhapur per te permiresuar menaxhimin e zonave te mbrojtura ka filluar te perdoret edhe ne vendin tone. Ne vende te ndryshme gjejme nje larmi te madhe konceptesh zonimi. Deri me sot, ende mungojne vleresime mbi efektivitetin e koncepteve te ndryshme te zonimit. Por ne te gjitha rastet zonimi vleresohet si nje instrument i pa zevendesueshem per permiresimin e menaxhimit te zonave te mbrojtura, nepermjet ndarjes se brendshme te nenzoneve me nivele te ndryshme natyraliteti, nevoja te ndryshme menaxhimi, rekreacioni, edukimi, presioni njerezor dhe ndikime te tjera.

Ne vendin tone per here te pare zonimi i siperfaqes se ZM u propozuar kuader te studimit per shpalljen e Liqenit te Prespave dhe Liqenit te Pogradecit, perkatesisht Park Kombetar dhe Peizazh i Mbrojtur, por qe nuk u morren ne konsiderate ne procesin e miratimit.

Ne zbatim te dispozitave te ligjit "Per zonat e mbrojtura" u hartua dhe u miratua VKM nr. 267, date 24.4.2003 "Per procedurat e propozimit dhe shpalljen e zonave te mbrojtura buferike". Sipas ketij vendimi duhet qe per shpalljen e nje zone te mbrojtur te percaktohen, paraprakisht, statusi i saj, kufijte dhe zonimi i brendshem, zona buferike rreth saj, administrata e ruajtjes se zones dhe varesia e saj, mundesite e perpunimit e te shfrytezimit te zones, te ardhurat qe mund te krijohen dhe perdorimi i tyre ne dobi te zones, ne baze te studimeve rajonale. Proces qe eshte ndjekur ne te gjitha zonat e mbrojtura te miratuara deri me tani, shoqeruar dhe me problematiken e nenzonimit te siperfaqes.

Nderkohe u fillua nga puna edhe per hartimin e Planeve te Menaxhimit per Zonat e Mbrojtura, me mbeshtetje te donatoreve te huaj dhe duke perdorur praktikat me te mira te tyre ne vendet ku ishin hartuar me pare keto plane. Por secili plan kishte individualitetin e vete, pra nuk mund te themi se kishte nje unifikim te hartimit te planeve te menaxhimit, per rrjedhoje dhe te zonimit. Zbatimi ne praktike solli veshtiresi dhe keqinterpretime.

Keshtu, permendim planin e menaxhimit per Parkun Kombetar Dajt (2004) ne te cilin propozohet:

- a. Zona Kyce (kryesore) CZ e ndare: CZ1-Nen zone ne ruajtje te vecante, CZ2- Nen zona mjedisore natyrore dhe CZ3- Monument natyre;
- b. Zona Rekreative (RZ), e ndare: RZ1-Zona Rekreativeaktive dhe RZ2-Zona rekreative natyrore;
- c. Zona e Perdorimit Tradicional (TUZ);
- d. Zona e Perdorimit Qendrueshem (SUZ);
- e. Zona e Perdorimit Ushtarak (MUZ).

Ne planin e menaxhimit per zonen e mbrojtur Llogara-Kraburun-Orikum-Tragjas-Dukat (2004) propozohet:

- a. Zona Qendrore (ZQ) e ndare ne: CZ1-Nen zona e ruajtjes se vecante, CZ2-Nene zona e mjedisit natyror; CZ3- Monumentetee natyres;
- b. Zona Rekreative (ZR) e ndare ne: RZ1-Zona Rekreative Aktive dhe RZ2-Zona rekreative natyrore;
- c. Zona e Perdorimit Tradicional (ZPT);
- d. Zona e Perdorimit Qendrueshem (ZPQ);
- e. Zona e Perdorimit Ushtarak (ZPU).

Ne planin e menaxhimit per zonen e mbrojtur Vjose-Narte, thuajse u ndoq po e njejta llogjike e procedure, por ne asnje rast nuk percaktohej shkalla e mbrojtjes se ketyre nenzoneve te zonimit.

Megjithese ky proces u konsideruar disi i pranueshem dhe i mire, u vrejten dhe mangesi e keqinterpretime per ceshtejnee zonimit, te kriterave qe duheshin perdorur, te perputhjes se shkalleve te mbrojttes me kategorine e zones se mbrojtur dhe saktesimi i veprimtarive qe nuk lejoheshin, ato te kerkonin leje dhe miratim, etj, duke krijuar dhe perplasje juridike ne interpretime tyre dhe me biznesin. Cdo vendim i ri per shpalljen e ZM apo dhe rregullimet e rishpalljes se ZM sipas propozimeve te planeve te menaxhimit te miratuar, vec nenzonimit percaktonjne dhe shkallen e

mbrojtjes per secilen nenzone. Por dhe ky proces ka interpretime te ndryshme deri ne konflikt juridike.

Zhvillimit e me pastajme sollen si rezultat domosdoshmnerine e saktessimin e ketij procesi, pasi ne mjaft ratse mendohej per nje perplasje midis kategorive, nenzonimit dhe shkalles se mbrojtjes. Per te saktesuuar keto probleme u be edhe nderhyrja ne ligjin “Per zonat e mbrojtura” i cili nder te tjera kerkonte, me udhezim te vecante te ministrit, dhe rregullimin e ketij procesi sipas nenit me poshtem.

Ne nenit 4/2 te ligjit “Per Zonat e Mbrojtura” percaktohet: **Zonimi i territorit te zones se mbrojtur**

1. *Territori i zones se mbrojtur ndahet ne nenzona, sipas rendesise se habitateve dhe te ekosistemeve qe bejne pjese ne to.*

2. *Zonimi i brendshem mund te permbaje zonen qendrore, zonen e rekreacionit, zonen e perdorimit tradicional, zonen e zhvillimit te qendrueshem dhe nenzona te tjera qe i pershtaten territorit. Ministri pergjegjes per mjedisin percakton, me udhezim, kerkesat dhe menyren e zonimit te territorit te nje zone te mbrojtur.*

3. *Zonimi perputh shkallen e mbrojtjes me vecorite e nenzones, duke mbajtur parasysh natyren e zones, llojet e veprimtarive njerezore qe zhvillohen ne te dhe ndikimin e tyre ne natyre.*

4. *Vendimi i Keshillit te Ministrave, qe shpall zonen e mbrojtur, percakton emertimin, siperfaqen dhe shkallen e mbrojtjes se nenzonave te saj.*

Edhe me keto rregullime ligjore perseri nuk u shmangen keqinterpretimet dhe konfliktet. Prandaj kerkohet te pergatitet ky udhezues, i cili duhet te percaktoj kerkesat, menyren e zonimit te territorit te ZM dhe perputhshmerine e shkalles se mbrojtjes me vecorite e nenzonave.

Pervoja nderkombetare tregon se nuk ka standarte apo rekomandime te mirefillta per nenzonimin e siperfaqes se zonave te mbrojtura. Por nder kohe pranohet qe nenzonimi eshte nje instrument i perhapur dhe i nevojshme per te permiresuar menaxhimin e zonave te mbrojtura i zhvilluar kryesisht ne siperfaqe te medha. Ne te gjitha rastet zonimi vleresohet per permiresimin e menaxhimit te zonave te mbrojtura, nepermjet ndarjes se brendshme te zonave me nivele te ndryshme natyraliteti, nevoja te ndryshme menaxhimi, rekreacioni, edukimi, presioni njerezor dhe ndikime te tjera.

**Ne Gjermani,** nuk ka nje standard kombetar per zonimin. Pergjithesisht, parqet kombetare kane 3 nenzona:

- Zona 1 (zona qendrore): Asnje nderhyrje njerezore, zhvillim natyror i pa shqetesuar. Ne disa raste nuk perjashtohen aktivite shume te kufizuara rekreative apo edukative (si ture, kulla vrojtimi, etj).
- Zona 2 (zona e menaxhimit): Zona 2a: lejohen nderhyrje te kufizuara ne kohe per ta pergatitur ate per te kaluar ne zonen 1. Zona 2b: menaxhimi per ruajtjen dhe mbrojtjen e disa llojeve dhe habitateve, perfshire menaxhimin nepermjet perdorimit te rregulluar.
- Zona 3 (zona rekreative): lejohet ndertimi dhe mirembajtja e infrastrukturave ne sherbim te turizmit si dhe aktivitetet rekreative.

Ne parqet kombetare zona qendrore (1) ze 20 – 91.5% te territorit, zona 2 ze 8.5 – 82% dhe zona 3 – 5%. Ne parqet natyrore zona 1 eshte me pak se 1%, zona 2 deri ne 12%, dhe shumica e territorit trajtohet si peizazh i mbrojtur (IUCN, IV).

**Ne Kanada**, ka nje strategji kombetare te detyrueshme per zonimin dhe nje manual te detyrueshem per planet e menaxhimit per zonat e saj te mbrojtura. Por megjithate, planifikimi i menaxhimit dhe zonimi i zonave te mbrojtura perdoret ne nje menyre mjaft te larmishme. Pergjithesisht perdoren 5 zona te ndryshme:

- Zona 1 (ruajtje speciale): zona speciale, te ndjeshme dhe te pa prekura me akses shume te kufizuar, edhe akses i helikopter nuk lejohet.
- Zona 2 (zone e jetes se eger): zona te medha, qe perfaqesojne ekosisteme te pa prishura te zones se mbrojtur, te cilat duhen ruajtur ne kushtet origjinale, nuk lejohet hyrja me mjete motorike, akses i kontrolluar ne shume pak zona, mundesisht nga ajri.
- Zona 3 (mjedis natyror): zona ne kushte te mira mjedisore, perdorim i kufizuar si dhe akses i kufizuar me mjete motorike (kryesisht transport publik).
- Zona 4 (rekreacion ne natyre): zona per aktivitete te ndergjegjesimit publik dhe edukimit, aktivitete ne natyre dhe infrastruktura per vizitoret, ruajtje e peizazhit dhe asnje ndikim ne mjedis.
- Zona 5 (sherbimi i parqeve): vendbanimet, ndertesa te medha per sherbime ndaj vizitoreve dhe qendra informacioni.

Dallimi bazohet ne ekuilibrin midis nevojave per ruajtjen e natyres dhe mundesive per perdorimin e qendrueshem, dhe rezulton ne nje zonim te shkallezuar sipas nevojave ekologjike dhe mundesive per turizem.

**Ne SHBA**, sistemi i menaxhimit te parqeve kombetare eshte nje nder me te miret ne bote. Te gjitha parqet kombetare jane shume mire te mbrojtur dhe te menaxhuara ne menyre efektive. Ekziston nje zonim lidhur me aktivitetet turistike me rregullore si te organizohet hyrja, ku te ngrihen infrastrukturatur, ku dhe kur te lejohen aktivitetet ne natyre, etj.

**Ne Kine**, sipas legjislacionit, gjithe zonat e mbrojtura duhet te ndahen ne 3 nenzona:

- Zona 1 (zona qendrore): per mbrojtjen e ekosistemeve
- Zona 2 (zona buferike): per zbutjen e ndikimeve nga aktivitetet njerezore
- Zona 3 (zona eksperimentale): per zhvillimin dhe perdorimin e qendrueshem.

Pra, keto pervoja nderkombetare tregojne se zonimi i zonave te mbrojtura eshte nje instrument i pa zevendesueshem per menaxhimin e zonave te mbrojtura. Eksperienat nderkombetare tregojne qe zonimi eshte edhe nje mjet kompromisi midis nevojave te ruajtjes se natyres dhe nevojave te perdorimit (ekonomik, edukim, rekreacion, etj). Ne zonat e mbrojtura duhet te jete e qarte: prioriteti i pare eshte ruajtja e natyres dhe e biodiversitetit, madje edhe rigjenerimi i tyre apo ri-futja e llojeve si dhe lidhet ne çdo rast me kufizime, duke perjashtuar llojet invazive.

Zonimi eshte nje instrument per te zbutur konfliktet midis administratres se zonave te mbrojtura me çdo lloj perdoruesi apo/dhe OJF-ve, kryesisht nepermjet nje procesi me pjesemarrje. Prandaj eshte thelbesore te vendosen rregulla te qarta, te thjeshta e te kuptueshme per secilen zone te mbrojtur ashtu si dhe per gjithe vendin. Ne kete koncept perjashtohen Rezervat e Biosferes per te cilat perdoret nje sistem zonimi tjetër.

#### **4. OBJEKTIVAT KRYESORE TE NENZONIMIT**

Procesi i zonimit te nje siperfaqeje te ZM eshte teper kompleks, delikate dhe kerkon mirecaktimin e veprimeve (planit te punes), mbeshtetje shkencore, teknike, materiale dhe integrimin e pervojave me



te mire ne kushte konkrete te zhvillimeve social-ekonomike, planit te pergjithshem te planifikimit te territorit, politikave, programeve per ruajtjen e natyres dhe te perparesive perkatese.

Ne zhvillimin e ketij procesi duhet te merren ne konsiderate dhe keto objektiva kryesore:

- Te siguroje mbrojtje per habitatet dhe llojet kritike apo tipike simbolike, ekosistemeve dhe proceseve ekologjike;
- te ndaje aktivitetet konfliktuale te njerezve;
- te mbroje cilesitepeizazhore dhe/ose kulturore te zones se mbrojtur, duke lejuar nje spekter te perdorur te arsyeshem nga njeriu;
- te ruaje zona te pershtatshme per perdorime te vecanta nga njeriu, duke minimizuar dukurite e ketyre perdorimeve ne zonen e mbrojtur;
- te ruaje disa pjese te zones se mbrojtur ne gjendjen e tyre natyrore te pa shqetesuara nga njeriu, vetem per qellime te hulumtimit shkencor apo edukimi.

Qeverisja, angazhimet e financimit, konteksti ekologjik, si dhe perdorimi i shkences dhe teknikat e reja te hartografimit mund te ndalojne ose te perparojne rezultatet e nenzonimit dhe objektivat e tij.

## 5. KRITERET E NENZONIMIT

Menaxhimi i zonave te mbrojtura, ne menyre te efekshme, do te arrihet edhe duke pershtatur modele te menaxhimit nenzonues, si *“metoda me e mire per zona e mbrojtura ne vendin tone te cilat jane edhe te banuara, me mjaft llojshmeri vepri matrisht sociale e ekonomike, etj. dhe si nje menyre e sigurimit e mbrojtjes se zonave vitale natyrore dhe te standarteve te deshiruara”*.

Ne percaktimin e nenzoneve te menaxhimit duhen patur parasysh keto kriteret:

- Vlerat biologjike dhe peizazhin
- Ndjeshmerite ekologjike
- Faktoret brenda dhe jashte vendit qe ndikojne ne menaxhim
- Menaxhimi ekzistues te mbrojtjes dhe te infrastruktures
- Jetesat ekzistuese
- Infrastruktura ekzistuese e turizmit
- Koncepti i perdorimit te qendrueshem
- Atributet fizike te nevojshme per menaxhimin
- Kerkesat e aktiviteteve mbeshtetesete menaxhimit p.sh, kerkimi.

Siperfaqja e zones se mbrojtur, sipas kategorive te percaktuara ne ligjin *“Per zonat e mbrojtura”*, te ndryshuar, ndahet ne nenzona, mbeshtetur ne gjendjen, rendesine e biodiversitetit, ekosistemeve, habitateve, llojeve floristike e faunistike, peizazhit, te vepri matrisht ekonomike, sociale, argetuese-sportive, historike-kulturore dhe turistike.

Procedura normale e nenzonimit fillon me nje studim te biodiversitetit (llojet e habitatet e rralla e te kercenuara, natyraliteti, ndikimi njerezor), studim socio-ekonomik, te pronesise mbi token, te drejtat ligjore apo tradicionale te perdorimit te tokes, arkitektures lokale dhe traditave lokale, aspekte te planifikimit hapesor dhe te pritshmerive nga zhvillimet e ardhshme, etj. Ne rezervatet natyrore te te gjitha kategorive, ruajtja e natyres eshte pikenisja e gjithe reflektimeve. Aspektet e zhvillimit ekonomik apo rajonal edhe pse te rendesishme jane ne rend dytesor.

Perzgjedhja (identifikimi) i nenzoneve dhe kufijve te tyre bazohet pike se pari ne:

- Gjendjen e natyres
- Hasjen e llojeve dhe habitateve te rralla apo te kercenuara
- Gjendjen e natyralitetit.

Vetem pas kesaj merren parasysh aspektet socio-ekonomike, si:

- Intensiteti i perdorimit
- Lloji i perdorimit
- Presioni i aktiviteteteve njerezore
- Pronesia
- Te drejtat e perdorimit
- Mundesite per te arritur marreveshje me perdoruesit dhe banoret, etj.

Kesisoj ne kete proces duhet te mbahet ne konsiderate dhe udhezuesi per zonat e mbrojtura dhe terminologjia e perdorur nga IUCN-WCPA (2008):

Zona e Mbrojtur perfshin token, ujerat e brendshme, zonat detare dhe bregdetare ose nje kombinim i dy ose me shume prej tyre. Hapesira ka tri dimensione: ajrore, siperfaqesore dhe nenujore (i zbatueshem per toke dhe detare).

Disa parime te mira ne praktiken e menaxhimit per zonat e mbrojtura duhet te kene dhe kerkese ligjore, vecanerisht te legjislacionit te zonave te mbrojtura. Elementet kryesore ligjore duhet te lidhen me sigurimin, autoritetin, kerkesat, udhezimet mbi procesin dhe permbajtjen e planeve te menaxhimit, duke perfshire zonimit e territorit. Gjithashtu, duhet te adresojte dhe zonat buferike/tampon, ruajtjen e zonave te lidhjes/biokorridoret dhe, kur eshte e mundur, t'i jape administrates se zones te mbrojtur nje rol ne ndikimin ose keshillimin e perdorimit te tokes, ujerave e burimeve natyrore, per te siguruar pajtueshmerine e menaxhimit te ZM me hapsiren gjeografike te peizazhit tokesor, ujqor dhe detare.

Legjislacioni i Zonave te mbrojtura duhet te njohet konceptin e zonimit si nje mjet i dobishem per menaxhimin dhe perdorimin e mencur. Ai duhet te tregojne se plani i menaxhimit, per nje territor te vecante, mund te ndajne zonen ne nenzona, per te percaktuar nevojat e ndryshme te menaxhimit (zonat e mbrojtura ne menyre strikte, menaxhim efektiv, tradicional, te qendrueshem, turistik, apo dhe per zonat e restaurimit, etj.).

Nenzonat, brenda nje zone e mbrojtur, mund te kene kategorite e veta te shkalleve te mbrojtjes, te percaktuara sipas ligjit ose ne planin e menaxhimit. Ne kete rast duhet te tregohet fleksibilitet per menaxhimin, pershtatjen dhe rregullimin e kategorive dhe/ose te shkalleve te ruajtjes se zones permes planit te menaxhimit. Njeherazi ofrohet dhe siguri me e madhe juridike ne lidhje me menaxhimin e ZM dhe te objektiveve te konservimit, por duhet pranuar se nje ndryshim ne kategorine e ZM duhet te ndodhe vetem me ligj.

Pergjithesisht zonimi eshte vecanerisht i dobishem per trajtimin e zonave te mbrojtura te medha shumeqellimshme dhe shumedimensionale, per sigurimin e lidhjes midis zonave thelbesore me ato buferike. Gjithashtu, mbetet nje mjet i pershtatshem per akomodimin e nje shumellojshmeri te qeverisjes apo rregullimit e ndarjeve te perziera brenda nje zone te vetme caktuar te mbrojtur. Per shembull, me ane te zonimit te kujdesshem mund te jete e mundur qe brenda nje zone te mbrojtur

shumeqellimshme mund te kete nje siperfaqe tokesore, detare ose te perziera, ose nje njolle me vlera te larta te biodiversitetit, nen nje rregjim te rrepte konservimi.

Ne rastin e monumentet natyrore te vecanta ose te perziera me zonat historike-kulturore mund te percaktohet, ne menyre specifike, nje skeme e zonimit, si pjese e nje plani te menaxhimit te zones se nderthurur. Kesisoj kjo zone mund te reflektoje edhe rregullime te ndryshme te qeverisjes ne lidhje me pronesine ose te drejtat e perdorimit.

Nje perfitim i rendesishem i nenzonimit, si nje mjet menaxhimi, eshte se ai lejon administraten e ZM, menaxheret, perdoruesit apo dhe palet e interesuara per te njohur dhe per te menaxhuar edhe nje zone te vecante per vlerat dhe qellimet e saj te shumta, ne varesi te vlerave te ruajtjes, te ndryshimit te kushteve dhe krijon fleksibilitet per menaxheret. Perpos kesaj autoritetet e zonave te mbrojtura duhet, gjithashtu, te kene detyrim per te bere te njohur, informuar dhe koordinuar veprimet e subjekteve te tjere publike apo privat, te cilet ndermarrin veprimeve apo planifikime ne zonat e mbrojtura, bazuar dhe konceptim e perdorur per zonimin e siperfaqes, te rendesise e ruajtjes se nenzonave, ndikimet potenciale dhe nevojen per thellimin e vleresimit te ndikimit ne mjedis.

## **6. ZHVILLIMI I PLANIT TE NENZONIMIT**

Plani i nenzonimit te territorit te zones se mbrojtur duhet ndjek hapat e meposhteme:

- a. Mbledhjen e informacionit te plote e te nevojshem mbi natyren, biodiversitetin, perdorimin e zones, nevojat e komunitetit dhe jetesa e tyre, etj.
- b. Pergatitja e projekt-planit te nenzonimit dhe konsultimi me aktoret e interesuar dhe komunitetin mbi sakesine dhe pershtatshmerine e shqyrtimit materiale dhe sugjerime per permbajtjen e planit te nenzonimit te propozuar.
- c. Reflektimi i komenteve ne projekt-planin e nenzonimit dhe i materialet shpjegues.
- d. Shqyrtimi i projekt-planit te nenzonimit me aktoret e interesuar dhe komunitetin.
- e. Finalizimi i projekt-planit te nenzonimit.

Ne nje kuptim te pergjithshem, sistemi i planifikimi eshte nje qasje e organizuar per te planifikuar ne nivelin lokal apo dhe kombetar. Ky nuk eshte nje koncept i ri, por bazohet mbi njohurite ekzistuese dhe i afrohet standarteve e praktikave me te mira. Sistemi planifikimi eshte nje kuader ne kuptimin dhe perdorimin e ideve ne kushte normale te ruajtjes se natyres, biodiversitetit dhe perdorimit te mencur te prodhimeve tradicionale, zhvillimit te qendrueshme, urban, infrastruktures, te vlerave historike e kulturore dhe turizmin e gjelber, te integruar me zhvillimin social dhe ekonomik te rajonit, nepermjet zbatimit te planifikimit hapsinor. Eshte gjithashtu mjet bindes per te tjeret, shume me teper se grumbullimi i te dhenave dhe duhet te jete nje proces dinamik.

Sistemi i nje plani kombetar per nenzonimin e territorit te zonave te mbrojtura, duhet te perfshije:

- ✓ Objektivat sqaruese;
- ✓ arritjen e promovimit te objektiveve;
- ✓ opsionet e identifikimit dhe implikimet e tyre;
- ✓ sistemet inkurajues per vleresimin e opsioneve;
- ✓ kuptimin ne arritjen e ceshtjeve;
- ✓ percaktimin e ceshtjeve te menaxhimit per te ardhmen;
- ✓ parashikimin dhe orientimin e veprimeve te ardhshme;
- ✓ identifikimin e prioriteteve per investime;
- ✓ bashkepunimin-koordinues te nje game te inputeve;
- ✓ ndertimin dhe mbajtjen e angazhimit;

- ✓ krijimin dhe ruajtjen e partneriteteve dhe duke krijuar nje baze per vleresimin e veprimit te ardhshem, dhe per monitorimin.

Kur sistemi i planifikimit praktikohet ne zonat e mbrojtura, duhet te maksimizoj karakteristikat e deshirueshmedhe ne perputhje me objektivat dhe planin kombetar te zonave te mbrojtura. Kjo duhet te behet ne ate menyre qe njeh kushtet mbizoteruesete çdo rajoni, te cilat rrjedhin prej trashegimise mjedisore, kulturore, historike, sociale, perfshi kontekstin politik, ekonomik dhe turistik.

Ne lidhje me zonat e mbrojtura, sistemi i planifikimit ka te beje me:

- Prioritet e shpalljes se zonave te mbrojtura si nje investim i vlefshem kombetare;
- percaktimin e marredhenieve midis (a) te njesive te ndryshme dhe kategorite e zonat e mbrojtura, dhe (b) zonat e mbrojtura dhe kategorite e tjera perkatese te tokes;
- duke marre nje pamje me strategjike te zonave te mbrojtura;
- percaktimin e roleve te aktoreve kryesore ne lidhje me zonat e mbrojtura dhe marredheniet midis tyre dhe kjo mund te perfshije krijimin e mbeshtetjes dhe nje elektorale per zonat e mbrojtura (p.sh. si nje mjet per kete qellim, jo si nje qellim ne vetvete);
- identifikimin e mangesive ne mbulimin e zones se mbrojtur (duke perfshire mundesite dhe nevojat ee lidhjes) dhe mangesi ne menaxhimin dhe identifikimin;
- ndikimet aktuale dhe potenciale, si ato qe ndikojnee mbrojtura nga zonat perreth tokave dhe ato qe burojne nga zonat e mbrojtura te cilat ndikojne ne tokat perreth.

Sistemi i planifikimi eshte nje menyre e organizuar per te kryer planin e ruajtjes/konservimit te ZM ne nivel lokal dhe kombetar dhe te sherbej si nje parim kryesor te menaxhimit efektiv te natyres dhe biodiversitetit. Pra ka qellim per te caktuar rregullat e deshirueshme te sistemit te planifikimit unik kombetar te ZM. Ne kete konteks nuk lihet jashte principi i zonimit te territorit te nje zone te mbrojtur, duke marre ne konsiderate statusin, shkallet e mbrojtjes dhe zhvillimin social-ekonomik te rajonit.

Udhezime nderkombetare (IUCN-WCPA) nder te tjera theksojne se "Qellimi i pergjithshem i nje sistemi te zonave te mbrojtura eshte qe te rrise efektivitetin e ruajtjes in-situ te biodiversitetit ". Si e tille ndihmon qasjen e te kuptuarit dhe te rolit te nje ZM ekzistuese ne permbushjen e qellimeve kombetare te konservimit te biodiversitetit, ne perputhje me objektivat e menaxhimit te percaktuara per ate rol. Gjithashtu, eshte e rendesishme qe te mbulohen boshlleqet, por te merren dhe qasje te cilat ndihmojne hapjen e procesit per caktimin e qeverisjes se re edhe kur territoret me vlerat te larta te biodiversitetit jane prone e pronareve privat. Nje qasje e kujdesshme e planifikimit dhe zonimit ndihmon per te identifikuar dhe per te kuptuar edhe faktoret e jashtem, te cilet mund te paraqesin kercenime te menjehershme apo dhe afatgjate ne ruajtjen dhe menaxhimin e zonave te mbrojtura.

## **7. MENYRA E NENZONIMIT TE SIPERFAQES SE ZONES TE MBROJTUR.**

Zonimi i siperfaqes eshte nje forme e rregullimit te perdorimit te tokes (bujqesore, pyjore, kullosore, ujore, detare, joprodhuese, urbane-troje, etj) qe perfshin ndarjen e nje siperfaqejeje ne nenzona, qe paraqiten ne harte si dhe rregullimi publik e privat i karakterit dhe i intensitetit te perdorimit te tyre, ne perputhje me ruajtjen e vlerave ekologjike dhe te biodiversitetin dhe zhvillimin e qendrueshem e te balancuar.

Planifikimi i perdorimit te tokes, eshte procesi i caktimit ne menyre te qarte i perdorimeve ose funksioneve te percaktuara per zonat e mbrojtura, i burimeve bio-natyrore dhe i vlerave shpirtore, historike, kulturore dhe arkeologjike. Rregullimi i perdorimit te qendrueshem te tyre pa shkaktuar shkaterrim te mjedisit fizik, biologjik, ekonomik dhe social kulturor dhe/ose pa shkaktuar nje ulje te papranueshme te cilesise se sherbimeve. Perdorimi i tokes brenda zones se mbrojtur percaktohet nepermjet nje procesi analitik sistematik, i cili bazohet ne objektivat kombetare, rajonale dhe vendore.

Po keshtu planifikimi hapesor, perfshin nivelet urbane (planifikimin urban) rajonale, kombetare dhe nderkombetare.

Udhezuesit nderkombetar (IUCN) konsideron se karakteristikate kryesore te rrjetit perfaqesues kombetar te zonave te mbrojtura duhet te perfshije:

- **Perfaqesimi:** aftesia per te perfshire dhe perfaqesuar shumellojshmerine e plote te biodiversitetit dhe karakteristika te tilla si llojet e peizazhit, vlerat tradicionale, kulturore, shembujt me te larte te unikaliteti te cilesise se ekosistemeve, habitateve, llojeve te kercenuara me zhdukje;
- **Pershtateshmeria:** mbeshtetur ne qendrueshmeriune e proceseve te ekosistemit, llojeve, popullatave dhe komuniteteve perberese te biodiversitetit te nje rajoni;
- **Koherenca dhe komplementariteti:** shkalla ne te cilen cdo vend bene nje kontribut pozitiv ne sistemin ne teresi;
- **Konsistenca:** zbatimi i objektivate te menaxhimit, politikave dhe shpalljen e zonave te mbrojtura ne kushte te krahasueshme me standartet nderkombetare;
- **Kosto-efektiviteti, efikasiteti dhe kapitali:** sigurimi i nje raporti te drejte midis kostove dhe perfitimeve qe rrjdhin nga menaxhimi i zonave te mbrojtura, barazi ne shperndarjen e tyre dhe efikasitet ne lidhje me numrin minimal dhe madhesise se zonave te mbrojtura te nevojshme per te arritur objektivat e caktuara;
- **Vazhdimesia:** aftesia per te promovuar mbijetesen afatgjate te biodiversitetit, te perfshire brenda nje zone te mbrojtur per mbajtjen e proceseve natyrore te qendrueshme dhe te popullatave duke perjashtuar kercenimet;
- **Elasticiteti:** aftesia per te pershtatur dhe per te mbeshtetur objektivat kryesore te konservimit ne nivel lokal dhe kombetar, duke marre ne konsiderate edhe ndryshimet klimatike dhe faktoret e tjere te kercenimeve globale.

Sic eshte pranuar nje nga praktikat me efektive per miremenaxhimin e zonave te mbrojtura, krahas rregullimeve ligjore, si pjese e sistemit te menaxhimit, mbetet hartimi dhe zbatimi praktike i planit te menaxhimit. Plani i menaxhimit orienton dhe ndrejton te gjitha veprimet dhe burimet brenda kufijve te nje zone te mbrojtur, por dhe rreth saj, ne perputhje dhe me mbeshtetje te statusit dhe objektivate te ruajtjes.

Praktikat me te mira te menaxhimit, legjislacioni, politikat dhe udhezimet nderkombetare, kerkojne pergatitjen e planit te menaxhimit, i cili do te ndihmoje e drejtoje autoritetet shtetore qendrore e lokale, administraten e ZM, shoqerine civile e OJF, komunitetin e biznesit dhe banoret lokal, per nje menaxhim te deshiruar dhe afat-gjate te perdorimit dhe realizimit te objektivate te caktuara, ne kuader te veprimeve shumeqellimeshme dhe te perbashketa.

Ne procesin e miremenaxhimit te zonave te mbrojtura dhe arritjen e objektivave te tyre ne perputhje me vlerat e biodiversitetit, te habitateve llojeve te kercenuara apo te rrezikuara, te peizazhit unik dhe monumenteve te natyres etj, shpesh nevojitet ndarja e siperfaqes ne nenzona menaxhimi, ku trajtimi i tyre behet ne menyre te pa varur. Zonimi eshte nje ndarje e siperfaqes se zones te mbrojtur dhe e truallit perreth ne nje numur nen-njesish menaxhuese.

Objektivat operacionale percaktohen per secilen nenzone menaxhimi. Brenda çdo zone objektivat dhe pershkrimet menaxhuese behen ne menyre te arsyeshme, uniforme dhe diferencohen ne tipe ose intensitet nga zonat e tjera. Zonimi eshte nje instrument opsional. Nje sistem zonimi mundet gjithashtu te perdoret per te informuar gjithe pjeset e perfshira rreth qellimeve te menaxhimit.

Ka shume tipe te ndryshme sistemesh zonimi. Por eshte e rendesishme te mbahet nje sistem zonimi sa me i thjeshte qe te jete e mundur dhe ti pershtatet objektivave strategjik te zhvillimit te rrjetit ekologjik te vendit dhe prioriteteve te zhvillimit social-ekonomik. Zakonisht, ka zona brenda vendit, qe kane objektiva te ndryshme nga mbrojtja e natyres, keto mund te perfshihen ne nje zone te ndare (psh. infrastruktura, qendra e vizitoreve, etj).

Shpesh ZM ka nevoje te mbrohet edhe nga faktoret demtues qe e kane origjinen nga jashte saj, qe çojne ne organizimin e nje zone buferike/tampon rreth (pjesa me e ndjeshme) ZM. Ketu kontrolli i aktiviteteve ushtrohen ne menyre indirekte me marreveshje menaxhimi ose psh. e drejte planifikimi. Nese nje “zone buferike” nuk eshte e mundur, atehere pjese kufizuese te vete ZM do te luajne rolin e zones buferike, duke u bere pjese integrale e saj.

Studimi dhe krijimi i cdo nenzone eshte nje proces shume delikat dhe i ndjeshem per te mos dorezuar pozicione apo mbrojtur pozicione qe jane te pambrojtshme apo te pamundura per tu zbatuar realisht ne terren. Kompromisi i mire i jep nga pak te dyja paleve. Eshte shume e rendesishme te sigurohemi qe regjimi i nevojshem mbrojtës qe vendoset duhet medoemos te zbatohet.

Zonimi i siperfaqes duhet te perdoret kryesisht ne zonat e mbrojtura te Kategorise se II-te (Park Kombetar), te Kategorise se III-te (Monument Natyre), kur siperfaqja eshte me e madhe se 100 ha, te Kategorise se IV-t (Rezervat Natyror i Menaxhuar”, te Kategorise se V-t (Peizazh i Mbrojtur” dhe te Kategorise se VI-t (Zone e Mbrojtur e Burimeve Natyrore te Menaxhuara).

Procesi i zonimit te siperfaqes se zones te mbrojtur duhet orientuar ne:

- Te mbrohen elementet e ndjeshem ekologjik te ndryshem nga shqetesimi dhe keqperdorimi per interesa publike e private.
- Te realizohet ndarja e perdorimeve te papajtueshme nga njeri-tjetri.
- T’u jepet prioritet perdorimeve apo qellimeve specifike ne nenzona te ndryshme.
- Mbeshtetja per zhvillimin e pershtatshem dhe te qendrueshem te zones se mbrojtur, ne perputhje me politiken e zhvillimit rajonal, kombetar e lokal.
- Mbeshtetja per rritjen ekonomike ne menyre te atille qe te arrihen perfitimet me te medha ekonomike, nderkohe qe ploteson aspiratat e komuniteteve vendore, me ane te marrjes parasysh te gjykimeve mbizoteruese te qendrueshmerise dhe vazhdimesise, per te ruajtur vleren afatgjate te burimeve mjedisore.
- Respektin per mjediset natyrore, pyjore-kullosore, bujqesore, lagunore, liqenore, detare,

bregdetare e nendetare dhe kodrinore-malore, duke synuar zhvillimin ne nje menyre te pademshme e te qendrushme te tyre si dhe te vlerave ekologjike, historike, kulturore, shpirtore e arkeologjike.

- Shmangien e zhvillimeve sporadike qe ndikojne mbi mjedisin natyror, kufizimi i perftimet potenciale ekonomike, te minimizojte demin mjedisor dhe riskun publik me ane te ndalimit apo te kufizimit dhe konsolidimin e zhvillimeve, ne perputhje me politikat e Qeverise, me strategjite, planet e veprimit dhe me skemat e planifikimit te territorit.
- Ekosistemet dhe habitatet natyrore me vlere te pazevendesueshme, mbrohen me ane te zonimit te hapësirës me nje ndalim te pergjithshem zhvillimi pa lejuar cenimin e tyre, por duke lejuar vetem proceset natyrore.
- Luginat, grykat dhe malet me shpate teper te pjerreta, mbrohen me nje ndalim te pergjithshem zhvillimi, duke u bazuar ne tere karakteristikat gjeomorfologjike dhe permban nje zone qe shtrihet jo me afer se 100 metra nga buza e çdo karakteristike gjeomorfologjike aktive.
- Deltat aktive, me nje ndalim te pergjithshem zhvillimi, dhe sipas rregulloreve te veçanta per lumenjte, afro 50 metra nga buza e karakteristikes se depozites aluviale aktive, dhe ne raste te veçanta jo me afer se 100 m per deltat kryesore te prirura drejt erozionit dhe qe perbejne vlere te rendesishme te peizazhit.
- Zona te prekshme nga erozioni, perkufizohen ne baze te gjeologjise, mbuleses vegetative, te pjerresise dhe te vrojtimeve ne terren.
- Zonat pyjore dhe pyjet mbrojtës, mbrohen me nje ndalim te pergjithshem shfrytezimi. Ne te cilin perfshihen te gjitha llojet pyjore dhe zonat pyjore origjinale te vendit qe nga bregdeti deri ne malet e lartat.
- Nderhyrjet ne zonat pyjore e kullimore komunale, bashkiake dhe private lejohen ne nenzonat e perdorimit tradicional e te qendrushem, vetem per plotesimin e nevojave per gatim e ngrohje te komunitetit, mbeshtetur vetem ne planet e menaxhimit te hartuar dhe projektet silvoteknike.
- Peizazhe bujqesore te mbrojtura, perkufizohen ato zona ku nje pjese e rendesishme e mbulimit te vegjetacionit pasqyron historine e bujqesise tradicionale te rajonit. Kjo kategori perfshin ullishtat, pemetoret, agrumet, vreshat dhe siperfaqe te tjera te tokes bujqesore e kullimore.
- Korridore te veçanta pamje dhe zonat e konservimit te peizazhit identifikohen dhe caktohen per korridore te veçanta panoramike. Kjo kategori synon te ruaje cilesine dhe karakterin paresor te pamjeve nga pika te favorshme veshtrimi, perfshin te gjitha pamjet ne drejtim te detit, malit, luginave, shpateve, grykave, etj, nisur nga rruget lokale e kombetare dhe ato ne brendesi te territorit.
- Fshatrat, zonat kulturore, historike dhe monumentet e rendesishme me vlere te pazevendesueshme, rregullohen me rregullore zhvillimi te detajuara dhe udhezime shoqeruese te institucioneve pergjegjese e planifikuese te territorit, duke patur parasysh nje rezerve minimale prej 500 metrash nga kufiri i caktuar i fshatit apo zones ne te cilin nuk lejohet asnje zhvillim i ri si dhe synon te ruaje ndarjen fizike, cilesine e peizazhit, karakterin tradicional dhe pamjet panoramike, pasi t'i nenshtrohen nje vleresimi teknik specialistesh, sipas dispozitave te ligjit “Per trashegimine kulturore”.
- Veprimtarite me ndikim te ndjeshem ne mjedis, ne nenzonat ku do te lejohen keto veprimtari dhe pas marrjes se lejes mjedisore, duhet te kene nje rreze me largesi jo me afer se 2 km nga nenzona qendrore dhe monumentet e natyres, dhe afro 1 km nga zonat e banuara e turistike. Inertet, minierat dhe gurore nuk duhet te kene pamje nga

autostradat, rruget kombetar dhe ato dytesore, nga qytetet e qendrat e banuara si dhe nga zona bregdetare, liqenore e etj.

Sipas udhezuesve te IUCN (1994) ne procesin e planifikimit dhe zonimit te siperfaqes se ZM duhet te mbahet ne konsiderate edhe objektivat relevante te menaxhimit per secilen kategori menaxhimi te pranuar ne vendin tone ne lidhje me nevojat e ruajtjes si elemente kyç te zonave te mbrojtura dhe zbatimit te standardeve me te mira te menaxhimit ne praktike.

OBJEKTIVAT E MENAXHIMIT	KATEGORITE e ZM (IUCN)						
	Ia	Ib	II	III	IV	V	VI
a. Kerkimi Shkencor	1	3	2	2	2	2	3
b. Ruajtja e Jetes se Eger	2	1	2	3	3	-	2
c. Ruajtja e llojeve dhe e diversitetit gjenetik	1	2	1	1	1	2	1
d. Mirembajtja e funksioneve mjedisore	2	1	1	-	1	2	1
e. Mbrojtja e vlerave specifike natyrore-kulturore	-	-	2	1	3	1	3
f. Turizmi dhe rekreacioni	-	2	1	1	3	1	3
g. Edukimi	-	-	2	2	2	2	3
h. Perdorimi i qendrueshem i burimeve te ekosistemeve natyrore	-	3	3	-	2	2	1
k. Mirembajtja e vlerave tradicionale dhe kulturore	-	-	-	-	-	1	2
1.Objektivat primare; 2.Objektivat dytesore; 3.Objektivat e mundshem per zbatim; - Te pazbatueshem							

Ekzistojne nivele te ndryshme te mbrojtjes te shprehura per lloje te ndryshme te ZM. Parim i pergjithshem eshte qe t'u jepet niveli me i larte i shkalles se mbrojtjes te zonave me vlera te larta te biodiversitetit, me te rendesishme ekologjike, peizazheve apo dhe atyre me veçori kulturore- arkeologjike, mirepo edhe kufizimet se cilat aktivitete lejohen jane gjithashtu shume te medha. Keto kufizime kane ndikim te madh per palet ne interes dhe perdoruesit e ketyre zonave. Pra kur percaktohet nje zone e mbrojtur, eshte me rendesi qe te behet baraspeshe e nevojave te perdoruesve dhe paleve ne interes perballe nevojave per ruajtje. Komunitetet lokale jane aktoret kryesor te suksesit per ruajtjen, perdorimin e menxhur te burimeve dhe miremenaxhimin e ZM. Gjithashtu, percaktimi korrekt duhet te behet ne ate menyre qe te permbush objektivat e menaxhimit te zones se propozuar per mbrojtje, por te jene te pranueshme dhe nga komuniteti.

Objektivat primare te menaxhimit te Kategorise I dhe II te IUCN-se jane: hulumtimet shkencore, mbrojtja e jetes se eger, mbrojtja e llojeve dhe e diversitetit gjenetik, mirembajtja e shterimeve mjedisore, turizmit dhe rekreacionit.

Pra thelbesore eshte te sigurohemi qe rregjimi mbrojtjes (shkallet e mbrojtjes) mund te vendoset dhe zbatohet per te gjitha zonat dhe nenzonat. Asgje nuk e demton me shume ruajtjen e natyres se sa krijimi i zonave te mbrojtura dhe hartimi i rregulloreve te cilat nuk zbatohen.

Ne menaxhimin e zonave te mbrojtura ose i zonave te destinuara per mbrojtje, eshte e nevojshme sepse:

- Mbrohen nga shqetesimet elementet e ndjeshem te biodiversitetit, ekosistemit, habitateve, llojeve te rrezikuara;



- ndahen përdorimet e papajtueshme, kërcënues dhe tjetërsues;
- u jepet prioritet përdorimeve të qëndrueshme pajtueshmeri me objektivat e konservimit të biodiversitetit dhe qëllimeve të menaxhimit të zonave të ndryshme.

Praktikisht në Shqipëri është zbatuar një praktikë e ndarjes së territorit të ZM, përgjithësisht, në pesë nënzona menaxhimi (ku në hartë janë paraqitur me shkurtësat ose ngjyra, për të cilat nuk ka patur ndonjë standard të unifikuar) si më poshtë:

- a. Nen-Zona Qendrore, e emërtuar ZQ, por në disa raste edhe me nëndarje të kesaj nënzona
- b. Nen-Zona e Rekreacioni, e emërtuar ZR.
- c. Nen-Zona e Përdorimit Tradicional, e emërtuar ZPT.
- d. Nen-Zona e Zhvillimit të Qëndrueshëm, e emërtuar ZZHQ
- e. Nen-Zona Bufërike, e emërtuar ZB

Gjithashtu, si në vendimin përkatës të miratimit dhe në planin e menaxhimit, është praktikuar që për secilën nënzona të bëhet përshkrim dhe një deklaram i qëllimit të menaxhimit të saj, duke theksuar fokusin e menaxhimit, shkallet e mbrojtjes dhe veprimtaritë prioritare për nënzonen me përshkrimet si më poshtë:

- Aktivitetet e lejuara (ato aktivitete që nuk kërkojnë aprovim për menaxhim individual sa herë që ndërmerren).
- Aktivitetet e papajtueshme (ato aktivitete të cilat duken qartë që janë të papajtueshme me qëllimet e zonës dhe në përgjithësi nuk do të lejohen në këto zone përveç se të ndonjë rasti të veçantë).
- Aktivitetet që kërkojnë aprovim manaxhues (ato aktivitete të cilat nuk janë qartësisht të papajtueshme me qëllimin e zonës por që mund të ketë ndikime negative dhe kështu qe kërkohet rasta pas rasti aprovim manaxhues, dhe në disa rasteraporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM).

Brenda kontekstit të menaxhimit të ZM, planifikimi nuk ka për qëllim që nënzonat manaxhuese duhen që patjetër të mbeten të fiksuara, me përjashtim të nënzona qendrore dhe ato të menaxhimit efektiv. Por, nuk është e dëshirueshme që ndarjet dhe kufijtë e nënzona të ndryshojnë shpesh, të pakten për shkak se ato, duke zbatuar menaxhimin ose aktivitetet ekonomike brenda zonave, kanë nevojë për disa shkallë sigurie me qëllim që baza për menaxhimin nuk do të ndryshojë papritur. Kështu që në zonat ku mendohet si e nevojshme për shkak të rrethanave që të ndryshojnë, dhe kjo kërkohet që funksionimi dhe efektiviteti i njesaj të ketë nevojë për t'u parë, duhet bërë për një periudhë 10 vjeçare me rishikimin të Planit të Menaxhimit të ZM.

Ndryshimet e ligjit “Për zonat e mbrojtura” krijojnë mundësinë që zonimi i sipërfaqjes së një zone të mbrojtura, vec atyre të cituara, mund të përbjehë edhe nënzona të tjera që i përshkruajnë territorin dhe qëllimeve për të cilat menaxhohen.

Në këto kontekste kushtet konkrete të vendit, kategoritë e menaxhimit dhe praktikën e zbatuar me parë, por dhe të përshkruara me ato me të mira ndërkombëtare në vendin tonë mund të përdoret sistemi i zonimit si më poshtë:

## **ZONAT E MENAXHIMIT**

1. **Nen-Zona Qendrore (ZQ)**, për të cilën zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes.

2. **Nen-Zona e Menaxhimit Efektiv (ZME)**, per te cilen zbatohet shkalla e dyte e mbrojtjes.
3. **Nen-Zona e Perdorimit Tradicional (ZPT)**, per te cilen zbatohet shkalla e trete e mbrojtjes.
4. **Nen-Zona e Rekreacionit (ZR)**, per te cilen zbatohet shkalla e trete e mbrojtjes.
5. **Nen-Zona e Zhvillimit te Qendrueshem (ZZhQ)**, per te cilen zbatohet shkalla e trete e mbrojtjes.
6. **Nen-Zona Buferike (ZB)**.

**a. Nen-Zona Qendrore (ZQ).** Performanca natyrore teper e larte, me pak ose aspak e shqetesuar nga veprimtarite njerezore. Ka perparesi ruajtjen teresore te natyres, te biodiversitetit, te llojeve te rrezikuara, monumentet e natyres, te peizazhit unik tokesor dhe detar, veçorite natyrore te jashtezakonshme gjeromorfologjike e paleontologjike, te karakterit dhe gjendjen e tyre pa qene nevoja e nderhyrjeve permiresuese te perhershme dhe qe menaxhohen ne ate menyre qe te ruajne gjendjen natyrore, mbahen resurset gjenetike ne nje gjendje dinamike dhe evolucion e sipersi dhe per qellime shkencore. Kjo zone gezon karakterin e mbrojtjes strikte.

Normalisht kufizohen kontaktet me publikun dhe perjashtohet perdorimi per pushim, shlodhje dhe argetim. Lejohen procese natyrore me nderhyrjen e menaxhimit minimale dhe pa zhvillimin e infrastruktures. Lejimi i studimeve, hulumtimeve dhe monitorim ne nivelin e ulet te rregulluar dhe me leje te vecante.

Vizitat ditore jane rreptesisht te kufizuara ne numer e vende vezhgimi, guida te lejuara vetem ne shtigjet e caktuara me ndikim teper te ulet brenda nje pjese te vogel te siperfaqe se nenzones maksimumi 10% e saj, nen drejtim e adminstrates se zones te mbrojtur, ne ate nivel qe ti sherbeje sa me mire mireqenies fizike dhe shpirterore dhe te ruajne cilesine e natyres se eger te zones per brezat e sotem dhe te ardhshem.

Veprimtarite sociale-ekonomike, sportive e argetuese, etj jane teresisht te ndaluara.

Mbrojtja sigurohet nepermjet patrullimeve te autoriteteve te zones se mbrojtur, duke zbatuar rregullave apo metodikat e perdorimit te percaktuara rreptesisht.

**b. Nen-Zona e Menaxhimit Efektiv (ZME).** Performanca natyrore e larte, me habitate shume te rendesishme natyrore ose vendbanime me lloje te rralla dhe te rrezikuara. Ka perparesi ruajtjen teresore te biodiversitetit, zonat natyrore dhe skenike me rendesi kombetare dhe nderkombetare per qellime shpirterore, shkencore, edukative, duke integruar menaxhimin e zones se mbrojtur me perdorimin e qendrueshem e te ballancuar. Gjithashtu, duhet te permbaje ne nje gjendje sa me natyrore qe te jete e mundur te shembujve perfaqesues te rajoneve fiziografike, te komuniteteve biotike, resurseve gjenetike dhe llojeve per te siguruar stabilitetin ekologjik dhe diversitetin.

Perdoret ne zonen qe karakterizohet me ekosisteme, vlere peizazhore dhe vlere tjera te natyres ne te cilat, mund te ushtrohet veprimtari qe nuk jane ne kundershtrim me qellimin e mbrojtjes dhe objektivat e menaxhimit. Lejohet vetem ekoturizem mjedisor, arsimor sipas rregullave dhe kufizime te qarta per nenzonat apo shtigjet e lejuara.

Nuk lejohen aktivitetet social-ekonomike. Ne kete nenzone zbatohet shkalla e dyte e ruajtjes.

Mbrojtja sigurohet nepermjet patrullimeve te autoriteteve te zones se mbrojtur, duke zbatuar rregullave apo metodikat e perdorimit te percaktuara rreptesisht.

**c. Nen-Zona e Perdorimit Tradicional (ZPT).** Performanca natyrore e mire. Jane zona ku prioritare mbetet ruajtja e biodiversitetit, peizazhit, habitatet, llojet floristike e faunistike te integruar dhe ne harmoni te plote me zhvillimin e qendrueshem e afat gjate te veprimtarive tradicional te bujqesise, pyjeve, peshkim, prodhimeve artizanale, turizmin mjedisor dhe vlerat shpirterore.

Zona duhet te siguroje respektimin e vlerave ekologjike, gjeomorfologjike, te objekteve te shenjta ose estetike per te cilat zona merret ne mbrojtje, duke eliminuar dhe parandaluar shfrytezimin ose perdorimin e burimeve natyrore te zones ne kundershtrim me qellimet dhe objektivat e caktuara. Njeherazi merren ne konsiderate nevojat e banoreve autoktone per permirsimin e jetese se tyre dhe u krijone mundesi per perfitime qe nuk vijne ndesh me objektivat e tjera te menaxhimit

Zona gjithashtu lejon mundesi hyrese per publikun e vizitoret per te njohur dhe shijuar vlerat gjithepershireshe dhe prodhimet dhe menyren tradicionale te jeteses se komunitetit. Administrata kontrollon perdorimin nga ana e vizitoreve per qellime shpirterore, edukative, kulturore dhe te pushuese ne menyre te atille qe ato/zonat te ruhen ne nje gjendje natyrore ose sa me afer natyres.

Ne kete nenzone zbatohet shkalla e trete e ruajtjes.

Mbrojtja sigurohet ne bashkeveprim me autoritete lokale, nepermjet patrullimeve te autoriteteve te zones se mbrojtur, duke zbatuar rregullave apo metodikat e perdorimit te percaktuara rreptesisht.

**d. Nen-Zona e Rekreacionit (ZR).** Performanca natyrore e mire. Percaktohet si nezone qe permban siperfaqe tokesore, ujore e detare te pershtatshme, ku nderthurja e veprimeve, e prodhimeve tradicionale te komunitetit, biznesit dhe te turizmit eshte ne perputhje me standartet e mbrojtjes se natyres dhe te biodiversitetit.

Zona duhet te garantoje qe te mos cenohet nderveprimi harmonik i natyres me kulturen permes mbrojtjes se cilesise se peizazhit, perdorimit te vazhdueshem te tokes ne menyre tradicionale, praktikave ndertimore dhe manifestimeve sociale e kulturore karakteristike e tradicionale te zones dhe te eliminoje apo dhe te parandaloje, ku eshte e domosdoshme, perdorimin e tokes si dhe kryerjen e aktiviteteve qe jane te papershtatshme ne permasa dhe/ose permbajtje.

Perpos kesaj zona duhet te krijojte mundesi per kenaqesi te publikut permes shlodhjes dhe turizmit ne perputhje me karakterin dhe permasat e karakteristikave thelbesore te zones duke inkurajuar aktivitete shkencore dhe edukative, te cilat do te ndihmonin ne zhvillimin dhe mireqenien per nje kohe te gjate te popullsise lokale dhe ne sigurimin e nje mbeshtetje te gjere publike per mbrojtjen e natyres.

Nder qellimet kryesore te kesa zone eshte te sjell perfitime ekonomike dhe te kontribuojte ne rritjen e mireqenies se popullsise lokale permes shfrytezimit te produkteve natyrore dhe sherbimeve ose te ardhura qe vijne nga format e pershtatshme te turizmit.

Zona permbane ne vetevete mundesi te gjera per edukim, rekreacion ne natyre te hapur, sportive, argetuese dhe facilitete qe respektojne funksionet e zones se mbrojtur, vlera ekologjike, peizazhin

natyror dhe ate kulturor dhe planit te pergjithshme kombetar te territorit, te miratuar nga K.K.T. (Keshilli Kombtar i Territorit).

Ne kete nenzone zbatohet shkalla e trete e mbrojtjes.

Mbrojtja sigurohet ne bashkeveprim me autoritete lokale, nepermjet patrullimeve te autoriteteve te zones se mbrojtur, duke zbatuar rregullave apo metodikat e perdorimit te percaktuara rreptesisht.

**e. Nen-Zona e Zhvillimi te Qendrueshem (ZZhQ).** Performanca natyrore e mjaftueshme. Ka perparesi harmonizimin e ruajtjes se natyres, te peizazhit dhe te biodiversitetit duke bashkerenduar menaxhimin e zones se mbrojtur me zhvillimin e qendrueshem ekonomik e social.

Zona krahas zhvillimi social-ekonomik duhet te siguroje dhe te ruaje kushtet e habitatit te domosdoshme per mbrojtjen e llojeve te rendesishem, grup-llojeve, komuniteteve biotike ose karakteristikave fizike te mjedisit, gje qe kerkon nderhyrje njerezore te vecanta per nje menaxhim efektiv.

Zona duhet te mbeshtet lehtesimin e kerkimit shkencor dhe monitorimin mjedisor te aktiviteteve paresore te lidhura me menaxhimin e qendrueshem te resurseve natyrore. Po keshtu te eliminoje ku eshte e domosdoshme dhe te parandaloje shfrytezimin apo zenien e zones me aktivitete qe bien ndesh me qellimet per te cilen ajo eshte marre ne mbrojtje.

Nepermjet perdorimit afat-gjate te qendrueshem dhe te barazpeshuar zona tu jape mundesi popullsise lokale, te perfshire brenda ZM, per te siguruar perfitime ekonomike qe nuk vijne ndesh me objektivat e tjera te menaxhimit. Pra te mbeshtese ato menyra jetese dhe aktivitete ekonomike qe jane ne harmoni me natyren dhe ruajtjen e konstitucionit shpirtoror dhe kulturor te popullsise lokale.

Zona gjithashtu, duhet te kontribuojne ne zhvillimin rajonal dhe kombetar, te nxise praktika mbareshtuese per qellime te prodhimit te qendrueshem, si dhe te mbroje resurset natyrore baze nga perdorimet per qellime te tjera te tokes qe mund te jene demtuese per diversitetin biologjik te zones. Zhvillimet urbane, te objekteve te ndryshme apo te infrastruktures per nevojat e banoreve dhe te biznesit kryen ne mbeshtetje te planeve te menaxhimit si dhe planeve te zhvillimit te miratuar nga KTT-ja.

Ne kete nenzone zbatohet shkalla e trete e mbrojtjes.

Mbrojtja sigurohet ne bashkeveprim me autoritete lokale, nepermjet patrullimeve te autoriteteve te zones se mbrojtur, duke zbatuar rregullave apo metodikat e perdorimit te percaktuara rreptesisht.

**f. Zona buferike (ZB) apo te tjera, ne perputhje me specifikat e vecanta te territorit.**

Keto zona duhet te perkufizohen vecmas dhe ne menyre individuale dhe, per rrjedhoje, mund te mbivendosen, meqenese kategorite nuk jane perjashtuese, ne aspektin social, ekonomik, kulturor, historik dhe ekologjik.

Ne çdo rast kur kategorite e mbrojtjes se mjedisit dhe te ruajtjes se peizazhit mbivendosen dhe ne qofte se zbatohen kontrole te ndryshme zhvillimi, atehere gjithnje do te mbizoterojne kontrolet me te rrepta (ato kontrole qe kufizojne zhvillimin ne menyre shume te rrepte si per minierat, guroret, shfrytezimin e pyjeve, kullotave, ujerave, ligatinave, liqeneve, ndertimin e qendrave te banuara e

turistike, rrugeve, hekurudhave, etj,) dhe sipas planeve te pergjithshme te zhvillimit te miratuar nga KKT-ja.

Zona buferike, si rregull i pergjithshem, perdoret per te rrethuar siperfaqen e zones se mbrojtur ne nje largesi, nga kufiri i saj, jo me afer se 500-1000 m, por mund te praktikohet qe nje zone me largesi jo me shume se 500 m nga kufiri i saj i brendshem, mund te jete zone buferike, duke u bere keshtu pjese integrale e siperfaqes se pergjithshme te zones se mbrojtur.

## **8. PJESEMARRJA DHE PUBLIKIMI**

Ky proces me pjesemarrje fillon me mire qe ne fillim te procedures me studimet baze, te cilat ndihmojne per ti dhene konceptit te zonimit nje mbeshtetje shkencore, dhe lejojne perfshirjen e aspekteve socio-ekonomike dhe aspekteve te tjera jashte ruajtjes se natyres ne krijimin e zonave dhe nen zonave te ndryshme. Kjo mund te zbusse konfliktet qe ne nise dhe ndihmon ne krijimin e nje baze te forte per diskutimin dhe negociimin gjate procesit me pjesemarrje. Studimi i nenzoneve, i planit te veprimit dhe negociimi mbi aktivitetet dhe kufizimet eshte rezultat i nje procesi me pjesemarrje midis autoriteteve te ruajtjes se natyres dhe gjithe aktoreve te tjere qe jane te angazhuar ne cdo lloj menyre ne zonen e mbrojtur.

Procesi me pjesemarrje eshte i hapur per te gjithe ata qe jane te angazhuar ne aktivitete te ruajtjes se natyres apo aktivitete te tjera ne zonen e mbrojtur, por procesi me pjesemarrje eshte vecanerisht i rendesishem per gjithe kategorite e perdoruesve, vizitoreve dhe mbi te gjitha banoreve te zones se mbrojtur.

Partneret kryesore ne procesin me pjesemarrje mund te jene:

- Ministria e Mjedisit
- Ministrite e tjera te linjes
- Komiteti i menaxhimit te zones se mbrojtur
- Administrata e zones se mbrojtur
- Keshilli i qarkut
- Komunitat/Bashkite
- Agjencia Kombetare e Planifikimi te Territorit
- Institucionet studimore e kerkimore
- OJF-te
- Shoqeria civile
- Perdoruesit/biznesi
- Vizitoret
- Banoret
- Pronaret.

Procesi me pjesemarrje duhet te filloje me perpunimin e nje draft koncepti zonimi. Pas perfundimit te draft konceptit te zonimit ai duhet publikuar ne vende publike qe njerezit ta shohin dhe shqyrtojne per nje periudhe te caktuar (2 muaj). Pas kesaj kohe, te gjitha verejtjet ndaj propozimit duhen adresuar, diskutuar dhe se fundmi negociuar e rene dakord. Vetem atehere koncepti i zonimit mund te miratohet e te hyje ne fuqi.

## **9. PROCESI I PERMIRESIMIT**

Zonimi duhet të jetë një instrument i qartë, i fortë por fleksibel për ruajtjen e natyrës. Nuk duhet të behet shumë i vështirë ndryshimi i formës së zonave/nën zonave, dhe ndryshimi i kategorive të tyre. Situata brenda një zone të mbrojtur mund të ndryshojë me shpejtësi dhe në mënyrë të papritur si pasojë e kercenimeve të reja, kërkesave të reja, ndryshimeve në njohuritë mbi ruajtjen e natyrës, rezultate të papritura të monitorimit, kthimit të llojeve të rralla apo të rrezikuara, rehabilitimi apo përkeqësimi i habitateve etj.

Berja e korrigjimeve apo përmirësimeve në zonimin e brendshëm nuk duhet të kërkojë procedurë të nivelit të lartë e të komplikuar. Zonimi duhet të jetë përgjegjës i administratës së zonës së mbrojtur, kombinuar me funksionin supervizues të **MM** apo agjencisë së zonave të mbrojtura në të ardhmen. Kjo nuk përjashton pjesëmarrjen e gjithë paleve të interesuara për këto rast apo korrigjimeve jashtë rishikimeve të planifikuara.

Rishikimi apo të pakten analizimi i konceptit ekzistues të zonimit duhet të jetë i detyrueshëm si pjesë e rishikimit të planit të menaxhimit. Por ndryshimet në zonim duhet të mundësohen edhe në intervale me të shkurtra nëse është e nevojshme.

Ndryshimet në zonim jashtë intervaleve të parashikuara për rishikimin e planit të menaxhimit duhet të ndjekin parimet e mëposhtme:

- Ngritja e nivelit të ruajtjes duhet të jetë përgjegjësi e administratës së zonës së mbrojtur
- Ulja e nivelit të ruajtjes duhet të miratohet nga MMPAU apo agjencia e zonave të mbrojtura në të ardhmen.

## **10. SHENIMI I ZONAVE**

Nuk ka shumë vlerë nëse zona e mbrojtur dhe zonat/nën zonat e brendshme janë hartuar në mënyrë të shkelqyeshme, por është e vështirë gjetja e vendndodhjes së tyre në terren, ku fillon e ku mbaron zona e mbrojtur apo zonat/nën zonat e ku janë kufijte e tyre.

Në nivel ndërkombëtar është e pazakonte të kemi një shenim special të kufijve të zonave të brendshme dhe nën zonave në zonat e mbrojtura. Në Shqipëri është fare e pazakonte të kemi çdo lloj shenimi të kufijve të zonave të mbrojtura. Në Shqipëri, hapi i parë duhet të jetë fillimi i shenimit të kufijve të zonave të mbrojtura, pa menduar për shenimin e zonave/nën zonave të brendshme. Sidoqoftë, shenimi i kufijve të zonave/nën zonave të brendshme mund të jetë i vlefshëm e ndoshta është i pashmangshëm shenimi i shenjave në kufijte me sensitive të disa zonave/nën zonave të veçanta, për të bërë të qartë se ku hyjnë në fuqi rregulloret respektive.

Mënyra më e mirë për ta bërë të qartë e të pagabueshme ku ndodhen zonat e mbrojtura dhe zonat/nën zonat e tyre është zgjedhja e kufijve natyrore (apo artificiale) për të shënuar kufizimet e tyre. Kështu është më e lehtë të shpjegohet ku ndodhen zonat e mbrojtura dhe zonat/nën zonat e tyre si dhe të dihet se ku janë këto kufij në terren.

Kufij tipike janë kreshtat, luginat, lumenjte, ndryshimet e menjehershme natyrore apo artificiale në vëgjetacion si dhe strukturat e përdorimit, linjat e trafikut si rruget, hekurudhat, kanalet, etj.

Një tjetër mënyrë me pak shpenzime për të dhënë informacion mbi pozicionin e zonave të mbrojtura dhe zonat/nën zonat e tyre është vendosja e tabelave informative në vendet publike pranë këtyre zonave. Këto tabela duhet të tregojnë një hartë të detajuar me kufirin e jashtëm të zonës së mbrojtur dhe kufijte e brendshme të zonave/nën zonave. Veç kësaj, këto tabela duhet të tregojnë informacion mbi natyrën e territorit dhe rregullat për të gjithë zonën e mbrojtur dhe në detaje për zonat dhe nën zonat.

Kufijte e zonave/nen zonave si dhe kufijte e zones se mbrojtur mund te shenohen me shenja me boje ne drure apo gure.

## 11. HARTOGRAFIMI

Koncepti i zonimit per nje zone te mbrojtur duhet te paraqitet ne dy forma te detyrueshme:











- Pjesa pershkruese
- Harta (pjesa hartografike).

Te gjitha zonat dhe nenzonat e perdorura ne nje zone te mbrojtur duhet te permenden ne te dyja format. Per hartat duhet perdorur skema e treguar ne tabelen e meposhtme.

E rëndësishme është të shenohen nenzonat me gerrat (shkurtesa te medha) perkatese te cilat duhen perseritur ne pjesen pershkruese.

Shenimi i zonave te ndryshme eshte krijuar si i tille qe te jete e pagabueshme si ne harta me ngjyra ashtu dhe ne harta bardhe e zi apo ne kopjet bardhe e zi te hartave me ngjyra.

**Tabela:** Shenimi i zonave te ndryshme ne harte

Nr.	Emertimi i nenzones	Shkurtesat emertimit	Kodi ngjyrave RGB	Ngjyrat	Shenja bardhe e zi
1	Nen-Zona Qendrore	ZQ	Red 0 Green 200 Blue 0		
2	Nen-Zona e Menaxhimit Efektiv	ZME	Red 135 Green 225 Blue 135		
3	Nen-Zona e Zhvillimit Tradicionale	ZZHT	Red 250 Green 210 Blue 180		
4	Nen-Zona e Rekreacionit	ZR	Red 255 Green 255 Blue 100		
5	Nen-Zona e Zhvillimit te Qendrueshem	ZZHQ	Red 200 Green 200 Blue 200		
6	Zona Buferike	ZB	Red 250 Green 200 Blue 250	